



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:018907

Datë: 28.02.2022

Numri i dokumentit: 02782619

PS.nr.3/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, kryetari i trupit gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Mirjetë Demiri – zyrtare ligjore pranë kësaj gjykate, në çështjen penale ndaj të akuzuarës P.K nga Britania e Madhe, për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, lidhur me nenin 56 par.1 dhe par.3 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me numër PPS.nr.33/2020, të datës 31.01.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 25.02.2022, në prezencën e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës – Naim Abazi, të akuzuarës si dhe mbrojtësit të saj avokatit Selim Selimi nga Prishtina, **me datën 28.02.2022** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 07.03.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

P.K., nga i ati ..., e ëma .. e gjinisë .., e lindur me datën .. në .. – ..., tani me vendbanim në 5 Moors ..., .., .., e martuar, nënë e tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, britanike – shtetase e Britanisë së Madhe, me numër të pasaportës ...

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse me date 07.01.2020, rreth orës 15:00/h, në Aeroportin e Prishtinës, duke e ditur apo duke pasur arsye që të dijë se ishte duke bartur mjete monetare, të fshehura në valixhen e saj personale, ku pas kontrollit zyrtar doganor është hasur një sasi e konsiderueshme e mjeteve monetare në valutën funte britanike dhe pas numërimit të kujdesshëm ka rezultuar se njëjta kishte fshehur shumën e përgjithshme prej 91,080.00 £ GBP (nëntëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë funte

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.06/L-074, i datës 14.01.2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19.04.2019.

britanike), duke i pasur në posedim ka tentuar që të fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me pronësinë e kësaj pasurie, apo në çfarëdo rrethanash, me qëllim që të shkaktoj shmangien nga pasojat juridike ose pasojat e mundshme ligjore, ku të njëjtat mjete monetare me kërkesë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës janë sekuestruar sipas Urdhërësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me numër: PNDS.nr.1/2020, të datës 14.01.2020.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Andaj, Gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 76, 92 dhe nenit 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.1.3 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit si dhe neneve 282 par.1 dhe 2 nënpar.2.5 dhe 365 të Kodit të Procedurës penale², të akuzuarën e:

G J Y K O N

ME DËNIM GJOBË, në shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarës në bazë të nenit 44 të KPRK-së, **Dënimi me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, I ZËVENDËSOHET me DËNIM ME GJOBË në shumën prej tetëmijë (8000) Euro.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 76 par.1 dhe par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, për dënimin me gjobë dhe dënimin e zëvendësuar me gjobë të akuzuarës ia shqipton:

DËNIMIN UNIK ME GJOBË në shumë prej tetëmbëdhjetëmijë (18.000) Euro, të cilin dënim e akuzuara duhet ta paguajë në afat prej dy (2) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e akuzuara, nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin unik me gjobë, atëherë të akuzuarës dënimin unik me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro, ashtu që të akuzuarës i zëvendësohet dënimin unik me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëqind (900) ditëve.

Në bazë nenit 92 par.1 të KPRK-së dhe nenit 282 par.1 dhe 2 nënpar.2.5 të KPP-së, ndaj të akuzuarës:

KONFISKOHET, shuma e parave prej: 91,080.00 £ (GPB) (nëntëdhjetë e njëmijë e tetëdhjetë funte Britanike), si pasuri që janë përfutuar me veprën penale dhe atë:

² Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejme KPP-së), nr.04/L-123, i datës 13.01.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<i>Sipas mjeteve monetare si në vijim:</i>
10 £ (GPB) x 200 PCE = 2000 £ (GPB)
20 £ (GPB) x 4104 PCE = 82,080 £ (GPB)
50 £ (GPB) x 140 PCE = 7000 £ (GPB)
<i>Totali:</i> 91,080.00 £ (GPB)

OBLIGOHET, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, t'i marr nën administrim dhe menaxhim paratë e konfiskuara me këtë aktgjykim dhe e njëjta të administrojë në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

Detyrohet e akuzuara, që t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate me datën 31.12.2022, ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.33/2020, të datës 31.01.2022, ndaj të akuzuarës P.Knga Britania e Madhe, për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.02.2022, në të cilën seancë kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës - Naim Abazi, e akuzuara P.Ksi dhe mbrojtësi i saj avokati Selim Selimi nga Prishtina.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës – Naim Abazi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarës, andaj ka propozuar që e njëjta të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

E akuzuara P.K, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se ndjehet fajtores për veprën penale për cilën është ngarkuar me aktakuzë, jam penduar për këto veprime dhe premtojë që në të ardhmen nuk të përsërisë veprime të kështilla.

Mbrojtësi i të akuzuarës P.K, av.Selim Selimi, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se e akuzuara gjatë fazës së hetimeve ka qenë në bashkëpunim të plotë me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për veprën penale për të cilën ngarkohet, prandaj ju njoftojë se njëjta pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnetin e plotë të saj pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës, e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë por dhe benefitet që përfitohen lidhur me pranimin e fajësisë. Po ashtu ju njoftojë gjendja e saj ekonomike është vështirësuar dhe po ashtu është diagnostikuar me një sëmundje autoimmune ashtu që vazhdimi i procesit gjyqësor do të ndikonte në degradimin e plotë të shëndetit të saj dhe mundësia e pranimin të fajësisë e cila edhe sapa ndodhi, do të ndikonte që të rikuperohet pa pasur ndikime shtesë negative në shëndetin e saj.

Prokurori i shtetit i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës – Naim Abazi, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se lidhur me pranimin e fajësisë konsiderojë se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par.1 i KPP-së, duke konsideruar se me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës janë përmbushur kushtet në pajtim me Kodin e Procedurës Penal dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, qoftë të natyrës materiale dhe personale të cilat vërtetojnë gjendjen faktik si dhe dispozitivin të kësaj aktakuze. Propozojë gjykatës që të njëjtës ti shqiptojë një dënim sipas ligjit, duke marrë parasysh rrethanat lehtësues me rastin e pranimin të fajësisë dhe rrethanave të tjera të cilat në i kemi specifikuar me arsyetimin e kësaj akuze, për të cilat besoj që gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duke analizuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese do të bjerë një vendim të drejtë.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e saj, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se e akuzuara P.K, me dashje ka kryer veprën penale shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 302 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale shpërlarja e parave e kryen: *“Kushdo që kryen veprë penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit”*.

Ndërsa në nenin 56 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit është parashikuar se formën themelore të veprës penale të pastrimit të parave e kryen: *“Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon”*:

nënparagrafi 1.5 ka përcaktuar se “*fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla*”. Në paragrafin 3 të këtij neni parashihet se: “*Pa cenuar legjislacionin penal në fuqi lidhur me personin i cili ka kryer veprat e ndërlidhura penale jashtë fushëveprimit të këtij paragrafi*”. Po ashtu nënparagrafi 3.1 ka përcaktuar se: “*personi mund të dënohet për veprë penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për veprë të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerr pasuria e fituar me anë të veprës penale*”.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës, kryetari i trupit gjykues pas tërheqjes për shqiptimin e dënimit duke i analizuar shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në nenin 360 par.2 të KPP-së, me të cilën është përcaktuar se: “*Gjykatën nuk e detyrojnë propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale*”, ka vendosur që kualifikimi ligjor i veprës penale për të cilën akuzohet e akuzuara me aktakuzë duhet të precizohet përkatësisht “*pas paragrafit 1 duhet të jetë edhe nënparagrafi 1.5*”, ndërsa “*pas paragrafit 3 duhet të jetë nën paragrafi 3.1*” i nenit 56 të Ligjit nr.05/L-për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, këtë duke u bazuar në veprimet e të akuzuarës të përshkruara në aktakuzë ngase kualifikimi ligjor i përcaktuar në aktakuzë nuk ka qenë i precizuar në këtë aspekt, prandaj gjykata sipas detyrës zyrtare ka bërë precizimin e kualifikimit ligjor në raport me veprimet e të akuzuarës të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase konsideron se me këtë precizim të kualifikimit ligjor nuk dëmtohet në asnjë raport pozita e të akuzuarës e cila në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprimet e përshkruara si në dispozitive të aktakuzës dhe për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarën Paula Krasniqi, e ka shpallur fajtores për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarës të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.5 dhe par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese dhe një rrethanë posaçërisht lehtësuese. Si rrethana rënduese gjykata ka marrë për bazë këto rrethana:

- Shkallën e Përgjegjësisë penale – që rezulton se e akuzuara kishte vepruar me dashje direkte andaj shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarës është konsideruar si shkalla më e lartë e fajësisë, përkatësisht e dashjes direkte, po ashtu motivet për kryerjen e veprës penale – siç rezultojnë nga rrethanat faktike por edhe nga provat e kësaj çështje penale se motiv kryesor ishte përfitimi financiar megjithatë për të arritur këtë motiv rezulton qartë se veprimet ishin shoqëruar me fshehjen e mjeteve monetare në valixhe me qëllim të shmangies së pasojave juridike gjatë kalimit të pikës kufitare.

Si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë:

- rrethanat personale të akuzuarës se është nënë e tre fëmijëve-të mitur. Pra, mos prania dhe mos kujdesi i të akuzuarës për fëmijët e saj të mitur, vetëm se do ta rëndonte gjendjen e tyre;
- bashkëpunimi dhe sjellja e saj tejet korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, pendimin e saj për veprën penal të kryer;
- faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët ka pasur të kaluar kriminale apo ka kryer ndonjë veprë penale, gjithashtu i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme, nuk do bie ndesh me ligjin dhe nuk do të përsërisë ndonjë veprë penale, qoftë e llojit të kësaj për të cilën është shpallur fajtor apo ndonjë veprë tjetër penale;
- Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Kështu që duke marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe se dënimi unik i shqiptuar me gjobë sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e saj, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjykata, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarës P.K dhe mbrojtësit të saj av. Selim Selimi, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tetëmijë (8000) Euro, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

8. Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata, duke u bazuar në nenin 92 par.1 të KPRK-së dhe nenin 282 par.1 dhe 2 nënpar.2.5 të KPP-së, ndaj të akuzuarës ka konfiskuar të hollat (paratë) si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si pasuri që janë përfituar me veprën penale dhe ka obliguar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, t'i marr nën administrim dhe menaxhim parat e konfiskuara me këtë aktgjykim dhe e njëjtat të administroi në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 451 par.1 dhe nenin 453 të KPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që e akuzuara t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar nenin 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI SPECIAL -
PS.nr.3/22, me datë 28.02.2022

Zyrtarja ligjore,
Mirjetë Demiri

Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë – Departamenti Special, nëpërmjet kësaj Gjykate.